



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/18
Datë: 06.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të Ligjit Nr. 04/L-177 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë Jashtë Vendit (GZ, nr. 18, 28 maj 2013) dhe të nenit 4 paragrafi 3. të Rregullores (QRK) - Nr. 34/2013 për Financimin e Dërgimit të Forcës së Sigurisë Jashtë Vendit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për dërgimin e kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar në Republikën e Shqipërisë.
2. Mjetet financiare për dërgimin e kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar sipas pikës 1. të këtij vendimi sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Presidentit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe autorizim të dërgimit të kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/18
Datë: 06.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 30,000.00 (tridhjetëmijë) euro për shërim jashtë vendit për z. Bujar Bukoshi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi Thesari me kod 11200, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, nën kategoria ekonomike subvencione për entitete jopublike me kod 21200.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë